

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaSwell® A

PROFILE QË BYMEHEN NË KONTAKT ME UJIN PËR IZOLIMIN E FUGAVE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Profile akrilike për izolim që bymehen në kontakt me ujin.

PËRDORIMET

Për izolim:

- Fuga ndërtimi
- Depërtime tubash dhe artikujsh prej çeliku nëpërmjet mureve dhe pllakave të dyshemesë
- Fugat e ndërtimit në betonin e parafabrikuar
- Fuga ndërtimi në tubacionet e kablllove, etj.
- Përrreth të gjitha depërtimeve nëpërmjet betonit

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim i lehtë
- Mund të aplikohet mbi nënshtresa të ndryshme
- Shumë ekonomik
- Bymehet në kontakt me ujin
- Mund të bymehet në plasaritje dhe hapësira
- Besueshmëri afatgjatë e testuar
- Rezistencë kundër ujit dhe substancave të ndryshme kimike
- Nuk nevojitet kohë ngurtësimi
- Nuk nevojitet saldim
- I adaptueshëm për t'u përshtatur me shumë aplikime nëpër detaje
- Disponohen lloje dhe përmasa të ndryshme

MIRATIME / STANDARDE

- MPA NRW: P-22-MPANRW-7678 - Miratimi gjerman për fugat e ndërtimit (18/11/2014)
- WISSBAU: 2012-206, Testim funksioni për kontrollin e kapacitetit izolues, (10/2012)
- FH Aachen: Qëndrueshmëri mekanike afatgjatë (08/12/2012)
- BBA British Board of Agrément, Certifikata e Miratimit të Inspektimit – Miratim teknik për Certifikatën e Miratimit të Ndërtimit 13/4994, 02/05/2013
- Raport testimi Vattenfall, Miratimi BBA, Testim i papërshkueshmërisë së ujit të barrierave hidrofile kundër ujit, 23/05/2012

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike

polimer akrilik

Ambalazhi

Rulona të paketuara në kuti kartoni

SikaSwell® A 2005

Rulon 20 m

Kuti me 1 ose 6 rulona

SikaSwell® A 2010

Rulon 10 m

Kuti me 1 ose 6 rulona

SikaSwell® A 2015

Rulon 7 m

Kuti me 1 ose 8 rulona

SikaSwell® A 2025

Rulon 5 m

Kuti me 6 rulona

Paraqitja / Ngjyra

profile akrilike, ngjyrë e kuqe, të bymueshme në kontakt me ujin

**Jetëgjatësia**

36 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar.

Kushtet e magazinimit

Të ruhet në vend të thatë dhe temperatura nga +5 °C deri në +35 °C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, UV dhe lagështia.

Përmasat**Lloji**

SikaSwell® A 2005

Gjerësia

20 mm

Gjatësia

5 mm

SikaSwell® A 2010

20 mm

10 mm

SikaSwell® A 2015

20 mm

15 mm


SikaSwell® A 2025

20 mm

25 mm

TË DHËNA TEKNIKE

Ndryshimi i vëllimit



Bymimi	Koha	Ujë i demineralizuar	Tretësirë e kripur 5 %
	3 ditë	~100 %	~60 %
	7 ditë	~150 %	~100 %
	14 ditë	~200 %	~120 %
	21 ditë	~220 %	~140 %

Presioni i bymimit ≤ 16 bar pas 3 ditësh i zhytur në ujë çezme

Temperatura e funksionimit 0 °C min. / +50 °C max.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Lagështia e përmbajtur e nënshtresës E thatë ose e lagësht mat.
Nuk është i mundur aplikimi në fuga ndërtimi me ujë të ndenjtur.

Temperatura e mjedisit +5 °C min.
Për instalim në temperaturë ambienti nën +5 °C, kërkohen masa të posaçme në përputhje me rregulloret përkatëse kombëtare dhe udhëzimet nga Sika

Temperatura e nënshtresës +5 °C min.
Për instalim në temperaturë ambienti nën +5 °C, kërkohen masa të posaçme në përputhje me rregulloret përkatëse kombëtare dhe udhëzimet nga Sika

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë ose e lagësht mat, pa kontaminues të sipërfaqes.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Grimcat e lira, disarmantët, koret, boja, ndryshku dhe materiale të tjera duhet të hiqen me përgatitje të përshtatshme manuale ose mekanike.

Sipërfaqet që janë shumë të ashpra kanë tendencë të rrjedhin më vonë. Rekomandohet nivelimi i betonit të freskët të hedhur me një dërrasë aty ku do të vendoset profili izolues.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

- Prisni profilin SikaSwell® A në gjatësinë e kërkuar
- Aplikoni SikaSwell® S-2 mbi sipërfaqen e pastër
- Ngjeshni profilin SikaSwell® A tek adezivi i sapoaplikuar SikaSwell S-2
- Ka rëndësi ngjitja e plotë mbi sipërfaqe
- Profilet SikaSwell® A kërkojnë beton të armuar / veshje betoni prej të paktën 8 cm
- Mbroni profilet SikaSwell® A kundër ujit (p.sh. shiu) derisa të hidhet betoni
- Lidhjet dhe qoshet duhet të bashkohen dhe të fiksohen

Në përgjithësi

- Është me rëndësi të arrihet një kontakt i plotë dhe i vazhdueshëm midis profileve SikaSwell® A dhe nënshtresës.
- Gjatë betonimit, ngjeshni mirë përreth profileve

SikaSwell® A për të siguruar një beton të dendur pa "hoje" apo boshllëqe.

- Duhet nxjerrë sasi e mjaftueshme SikaSwell® S-2 për të niveluar ashpërsinë e nënshtresës.
- Aplikoni SikaSwell® S-2 në shtresë të ngushtë (madhësi e prerjes trekëndore ~5 mm) mbi nënshtresë. Profilet duhet të vendosen max. brenda 30 minutave dhe të ngjeshen mirë tek izoluesi ende i freskët SikaSwell® S-2 derisa sasi të vogla SikaSwell® S-2 të rrjedhin nga të dy anët e profilit.
- Lejoni ngurtësimin e SikaSwell® S-2 për 2–3 orë përpara hedhjes së betonit.
- Këshillohuni me skedën teknike të SikaSwell® S-2.

KUFIZIME

- Profilet SikaSwell® A zgjerohen në kontakt me ujin. Kjo gjë nuk ndodh menjëherë, por ngadalë pas disa orësh. Megjithatë, këshillohet që profilet SikaSwell® A të mos lihen në ajër të hapur apo të ekspozuar ndaj ujit të shiut (max. 24 orë për aq kohë sa uji mund të kullojë)
- Mos përdorni profilet SikaSwell® A për fugat e lëvizshme!
- Nëse papritur rritet niveli i ujit, hidroizolimi i fugave do të arrihet vetëm pasi të jenë bymuar profilet SikaSwell® A
- Në gjendje totalisht të thatë, profilet SikaSwell® A tkurren në përmasat e tyre fillestare, por zgjerohen sërish në kontakt me ujin.
- Për presion uji mbi 2.5 bar rekomandohet instalimi i një sistemi shtesë mbështetjeje si sistemi SikaFuko®
- Nëse profilet SikaSwell® A do të fiksohen përreth tubave me diametër të vogël përdorni fiksion shtesë mekanik si teli

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaSwell® A

Shkurt 2019, Botimi 01.01

020703300100000010

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

RREGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaSwellA-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf



BUILDING TRUST